

PERSHKRIM TEKNIK

“Pelikan” sh.p.k

Pershkrim TEKNIK

Vend-ndodhja ku do te zhvillohet ky aktivitet eshte ne Spitall ,Komuna Rrazhbull Durres.

Nga investitori eshte zgjedhur kjo pike per ushtrimin e ketij aktiviteti per arsye se:

-Eshte shfrytezuar trualli ne pronesi te vete investitorit dhe se eshte pike e rendesishme per veprimtarine e synuar.

-Eshte prane rruges kryesore dhe jo me larg se 5-6 km larg Portit Durres,si dhe ekziston infrastruktura e nevojeshme, energji elektrike,uje,sistemi I kanalizimeve,rrugeve etj.

-Eshte ne aks rrugor te rendesishem per zonen ne fjale,pasi lidh qytetet e Shqiperise me qytetin e Durresit, me Portin e Durresit dhe ate te Porto-Romanos.

-Teritori ku zhvillohet aktiviteti dhe zona per-rreth eshte ne planifikimin urban si zone industriale.

Ky projekt do te realizohet ne truallin ne pronesi te investitorit ,I cili ndodhet ne Spitall rruga DALMACIA,ku ne distanc rreth 800 m lidhet me rrugen Spitall-Vrine Komuna Rrazhbull Durres.

Duke u bazuar ne dokumentacionin teknik dhe ligjor qe disponon investitori,si dhe nga verifikimet e bera ne vend,rezulton se trualli ku zhvillon aktivitetin eshte prone e tije.

Siperfaqja e prones eshte	29260 m2
Siperfaqja e objektit	29260 m 2 .
Ambjente zyra&sherbimi	111,9 m2
Siperfaqja e peshores	102,2 m2.
Sheshi I mineralit te kromit	8576 m2
Sheshi I konteinereve	20469,9 m2

Per kryerjen e aktivitetit,investitori ka ne inventar disa makineri dhe paisje:

- Terminali me te gjitha instalimet e nevojeshme per kete qellim.
- Mjete transporti te formave e tonazheve te ndryshme .
- Mjete &automjete ngarkim shkarkimi te formave e tonazheve te ndryshme.
- Automjet me bot adaptuar per sperkatje me uje te teritorit&Mineralit.
- Kontenier metalik.
- Gjenerator me naft cop 1.
- Impiantet elektrike,hidraulike + pusi etj.
- Ambjente zyrash,tualeti,qendrimi te punetoreve.

Mund te konfirmojme se makinerit dhe paisjet jane bashkohore dhe sipas standarteve te BE,te certifikuara dh te pershtatshme per keto lloj aktivitetesh.

Lendet e para qe perdoren:

- Mineral Kromi kokerr
- Mineral kromi koncentrat

Proçeset teknologjike

Gjat zhvillimit te aktivitetit **Shkarkim,Depozitim,Perpunim te Ngarkeses** (Mineral Kromi),nuk zhvillohen proçese teknologjike te mirefillta,pasi ketu kemi te bejme vetem me proçedura te shkarkimit,depozitimit,perpunimit te ngarkeses te mineralit te kromit,pra jo me pasurim,perpunim apo copezim te ketij minerali.

Raport analizat behen per krom kokerr dhe koncentrat kromi,siç shihet ne permbajtjen e tyre perkatesisht ka:

Krom Kokerr	Koncentrat Kromi
Cr ₂ O ₃ =====40,30%	===== 39,10%
SiO ₂ =====12,30%	===== 13,40%
MgO =====22,68%	===== 23,30%
Al ₂ O ₃ ===== 7,10%	===== 7,30%
Cr/Fe ===== 2,90:1	===== 2,78:1

Nga studimet e bera,si dhe nga vet permajtja e mineralit te kromit,rezulton qe nese nuk perpunohet apo coptohet ky lloj minerali nuk shperbehet,pra mbetet ne gjendjen e tije te prodhuar,transportuar,depozituar apo perpunuar per ngarkesa te metejshme(ne rastin tone ne krom kokerr apo koncentrat kromi).

E vetmja mbetje qe mund te realizohet nga ky aktivitet eshte **pluhuri** I cili nga subjekti eshte zgjidhur nepermjet sperkatjes se mineralit me uje dhe nepermjet sperkatjes apo renies se shiut realizohet **balte** nga vet permbajtja e mineralit te prodhuar ne miniere pasi nuk eshte 100% e paster gje te cilen e tregojne edhe analizat qe paraqitem me larte.Pikerisht per keto mbetje investitori ka marre masa siç do ta trajtojme edhe me poshte.

Gjat zhvillimit te ketij aktiviteti mund te themi se kryhen disa operacione zinxhir pune (kryesisht me paisje e mjete motorike/elektrike),te cilat ne do ti trajtojme si me poshte:

Shoqeria "PELIKAN"shpk Durres ka nje kontrat me Fabriken e pasurimit te kromit Bulqize; shoqerine"MALI"shpk;Shoqerine "LAHAZE"shpk.Keta subjekte me mjetet e tyre te transportit (kamiona te tonazheve te medha)vetshkarkues,me kazan metalik dhe te mbuluar me mushama , per te mos lejuar ndotje mjedisi nepermjet derdhjes apo pluhurit qe mund te shkaktohet,sjellin mineral Kromi ne terminalin Spitali te shoqerise "Pelikan"shpk Durres ne dy lloje;

a.Krom kokerr dhe b.Koncentrat kromi.

Siperfaqia ne dispozicion eshte 5.000-10.000 m².

Kapaciteti ishte:

a.krom kokerr rreth	4.000 ton/muaj
b.koncentrat kromi rreth	2.000 ton/muaj
Total	6.000 ton/muaj

Ndryshimi kerkohet : Kapaciteti Krom kokerr te ndryshoj nga 4 000 ton/muaj dhe behet 18 000 ton/muaj

Pasi kamioni vjen ne vend shkarkim,hiqet mbulesa e mushamase dhe masa I nenshtrohet lagies me uje nepermjet hidranteve ne forme shiu qe jane ne teritorin e objektit,proçes I cili realizohet gjate gjithe kohes se shkarkimit te mineralit nga kamjoni.Sasia e ujit te perdorur eshte e tille qe te mos shkaktoi balte apo llumra, por ne mase te tille sa per te mos çliruar pluhura,me qellim te mos ndotet ajri.

Ne raste te teprimit me uje,apo te renies se sasirave te medha te shiut, vet sheshi I objektit eshte projektuar e ndertuar ne forme drejtkendeshi te rregullt,ku gjatesia eshte ne drejtimin Perendim-Lindje.

Ne te dy anet fundore te gjeresise dhe drejtim gjatesor jan funksional kanale(kuneta) te betonuar me dimensione 60 cm I gjere dhe rreth 20 cm I thelle te cilet kan pjerresin e nevojeshme per te kryer normalisht funksionet e tyre.

Vet sheshi eshte I teri I betonuar ne forme(kurriz peshku)me pjerresi te lehte ne drejtim te kanaleve (kunetave),me qellim qe ujrat e teperta,llumrat apo balta te rreshqasin lirshem ne kuneta.Kunetat ne drejtimin Perendim-Lindje kane pjerresin e duhur si dhe ne pjesen fundore te tyre pikerisht ne pjesen Lindore te objektit ka nga nje vaske dekantimi te ujit,llumrave apo baltes qe realizohet ne sheshin e objektit te cilat ne menyre periodike pastrohen manualisht nga punetoret apo thithen nepermjet autoboteve,kjo ne varesi te mbetjeve ne dekantues.

I gjithe sheshi,kanalet anesore dhe vaskat e dekantimit siç thame edhe me lart,jane te shtruara me beton te nje marke e cilesie te larte dhe me pjerresi te tille per te perballuar edhe rreshjet maksimale qe mund te bien ne njesi kohe te shkurter,duke patur ne konsiderat edhe uje koeficient rezerv per keto raste.

Pas perfundimit te shkarkimit minerali I nenshtrohet perpunimit te ngarkeses:

1. sistemimit te tije ne form pirgjeshe piramidale,operacion I cili kryhet nepermjet fadromave ,mund te theksojme se ne objekt ka fadromat te madhesive te ndryshme per t'iu pershtatur çdo operacioni pune,fadromat jane me goma per te mos demtuar shtresen e sheshit.

2.Kryhet operacioni I futjes se kromit ne kontenier metalik te mbyllur (proçedure qe kryhet me BOBCAT).(Nese minerali eshte I thate dhe eshte burim per çlirim pluhuri,ai I nenshtrohet sperkatjes me uje nepermjet hidranteve shihedhes me qellim te mos ndotjes se ajrit).

3.Ngarkesa ne kontenier i nenshtrohet peshimit e standartizimit ne peshoren elektronike e cila ndodhet ne terminalin e Spitalles,*shih.fotot & plan vendosjen.*

4.Sipas planifikimit,kontenieret I nenshtrohen ngarkeses ne trajlera operacion I cili kryhet nepermjet automakinerive ndodhur ne inventarin e shoqerise "Pelikan"ne terminalin Spitall.

5.Trajlerat me kontenier levizin nga terminali Spitall ne drejtim te Portit Durres per tu ngarkuar ne anije.ky transport kryesisht planifikohet te kryhet ne orare me trafik sa me te kufizuar,(ne oret e parate mengjezit apo naten).

Pra te gjithe proçeset qe kryhen ne kete veprimtari,jan te programuara te realizohen ne kushte sa me optimal, per te mos lejuar ne asnje moment ndotje mjedisi,aq me pak ndotesit te rrezikojne jeten e njerezve.

Pershkrimi I te gjith instalimeve te pikes.

Objekti eshte ndertuar me siper marrje ndertimi nga shoqeri ndertimi e specializuar per kete qellim.

I gjith objekti eshte I rrethuar me nje mur me lartesi 2.4 m, vendosur mbi themele beton arme rreth 1 m thellesi, ka dy porta rreshqitese me zgar metalike 7 m te gjera, ku njera sherben si port hyrese ne objekt e cila ndodhet ne pjesen Jug-Perendimore te objektit, ndersa porta tjeter sherben per daljen nga objekti e cila ndodhet ne pjesen Jug-Lindore te objektit.

Instalimet kryesore ne kete aktivitet jane ato qe lidhen me shkarkimin, depozitimin dhe perpunimin e ngarkeses se mineralit te kromit..

Teknologjia e perzgjedhur eshte e parametrave europiane dhe teper efikase ne funksionet e saj.

Kryesisht instalimet jane bere nga shoqeria "PELIKAN" shpk nepermjet specialisteve perkates te subjektit, I cili ka bere furnizimin me makinerit dhe linjat teknologjike qe perdoren ne kete aktivitet.

Makineri, paisje & instalime te veçanta i ka realizuar edhe me kontrat siper marrje me subjekte te tjera te specializuar per keto lloj teknologjishe.

Ne terminal, ndodhen ambjenti I zyrave, dhomat e xhveshjes /pushimit/ngrenies se punonjesve, tualetit. Brenda teritorit te objektit ka te ndertuar edhe nje grop septike me dimensione /kapacitet te mjaftueshem, me kaparderdhje ne te cilen shkakohet ujrat e tualetit e cila pastrohhet periodikisht nepermjet nje autoboti.

Siç kemi theksuar edhe me lart I gjith sheshi eshte I stabilizuar pasi ne thellesi rreth 80-100 cm jane te ngjeshur stabilizant(gur&çakull), siper tyre ka zgar hekuri dhe e gjith siperfaqja eshte e shtruar me beton-arme ne form kurriz peshku, te cilesise e markave per keto veprimtari.

Ne te dy anet e sheshit siç kemi permendur edhe me lart jane kanalet/kunetat anesore ne drejtim gjatesor Perendim-Lindje me gjeresi 60 cm dhe thellesi 20 cm. dhe ne pjesen fundore te tyre vaskat e dekantimit.

Ne te gjithë sheshin e objektit ka një sistem kanalizimesh dhe pusëtash kontrolli të mbuluara me kapak betoni për të mos lejuar çfryrjet, të cilat shërbejnë për mbledhjen e ujrave të shiut apo teknologjike me qëllim që të mos lejohet ndotja e mjedisit përreth.

Ne ane dhe të djathtë të hyrjes në objekt është e montuar peshorja elektronike (për pasha të renda).

Ne formë harmonike janë të vendosura 4 kollona metalike ndriçimi në lartësi 7.5 m nga toka me nga 4 prozhektor seicili, të cilët bëjnë të mundur ndriçimin e të gjithë teritorit të sheshit të objektit për të bërë të mundur të gjithë operacionet e veprimtarisë së subjektit edhe natën.

Ne të gjithë sheshin janë të montuar depozita uji dhe jo më pak se 6 hidrante. Brenda teritorit të pronës është prezent edhe një pus uji, ku në të është e montuar një elektropomp zhytëse i cili siguron ujë teknologjik pa ndërprerje për nevojat e aktivitetit.

Është i përcaktuar sheshi i vendqendrimit të makinerive, sheshit të automjeteve, sheshit të konteniereve dhe sheshit të kromit kokërr & koncentratit të kromit.

Në teritorin e pronës së tijë ka të ndërtuar një kabine elektrike e cila ndodhet në teritorin e serave me ngrohje nga ku me kabull 3-fazor nëntokësor mer energji elektrike për terminalin. Në teritorin e terminalit ka të inkasuar në mur kuadrin elektrik me tokezimet konform standarteve, me automat për seicilen paisje/makineri elektrike apo ndriçimin.

Të gjitha instalimet janë bërë me materialet me cilësore ndodhur në tregun e sotëm vendas e ndërkombëtar, përshatur me normat e BE.

Linjat e perzgjedhura kan keto cilesi:

-Përpunimi dhe ambalazhimi bëhet me kv;ton në masën standarte dhe kontrollohet në çdo kohë duke bërë kalibrimin standart në peshorë.

-Sistemi I aparaturave siguron hermetizim total pa lejuar rrjedhje të produkteve në ambient.

-Elektromotorret e linjave e makinerive janë të llojit për keto raste.

- Linjat dhe makinerit janë të paisur me sistem elektrik komandimi automatik.

-Kontrollet e herpashëshme nga organet kompetente, garantojnë shkarkimin, depozitim, përpunimin e ngarkesave të mineralit të kromit konform standarteve sasiore dhe cilësore të këtyre produkteve.

Proçesi I levizjes se produkteve brenda hapsires se kompleksit mund te ndahet ne:

-Proçesin e furnizimit e te magazinimit.

-Proçesin e perpunimit te ngarkeses

Tregtimi:

Do te realizohet nepermjet konteniereve metalik te mbyllur te ngarkuar ne trajlera te posaçme. Ata do te levizin ne hapsirat e brendeshme dhe te jashteme te kompleksit nepermjet nje kontrolli te rrepte te punonjesve duke zbatuar me rigorozitetin me te madh rregullat e sigurise per keto raste.

Te gjitha proçedurat e furnizimit,depozitimit,perpunimit te ngarkeses dhe transportit te produkteve do ti nenshtrohen funksionimit te ligjit dhe rregullave ne fuqi per keto raste,gje e cila eshte detyr e punedhenesve dhe e punemarresve, njekohesisht edhe e institucioneve perkatese.(lihet detyre qe te behen instruktimet e nevojeshme sipas ligjit per rregulloren e sigurimit teknik,duke I evidentuar me shkrim ata dhe ky dokumentacion te ruhet bashk me dokumentacionin tjeter te operatoreve ne kete objekt).